



Gladiola Dona

Radio-valë drejt sipërmarrjes

Turizmi është një nga sektorët më premtues për sa i përket rritjes ekonomike në Shqipëri, por ka pak njerëz të trajnuar profesionalisht për t'ju përgjigjur numrit në rritje të vendeve të lira të punës që lidhen kryesisht me shërbimet në këtë sektor. Këtë ngërç përpiqet ta zbusë Akademia e Turizmit dhe Mikpritjes, që është një shkollë e re profesionale, dhe e para sipërmarrje private e llojit të vet në Shqipëri.

Gladiola Dona është themeluesja, drejtuesja dhe njëherësh pedagoge në Akademinë e Turizmit dhe Mikpritjes; ajo është diplomuar në "Salzburger Toursimusschulen" - një nga shkollat më të mira të Austrisë në fushën e turizmit. Gladiola është ndjekëse e rregullt e programit radiofonik të përjavshëm "Të reja mbi punësimin" në Club FM, që mbështetet

Radio wave towards entrepreneurship

Tourism is one of Albania's most promising sectors in terms of economic growth; however there are few professionals ready to fill in the rising number of vacancies in this sector. Here is where the Hospitality and Tourism Academy comes in, a brand new professional training center and very first private institution aimed at addressing this issue.

Gladiola Dona is the founder and director of this academy; she is a graduate of the "Salzburger Toursimusschulen" -one of Austria's best tourism schools- and currently she is one of the lecturers at the Hospitality and Tourism Academy in Tirana. Gladiola is a regular follower of "Employment News" on Club FM Radio – the weekly show supported by RisiAlbania that features conversations about finding,

nga RisiAlbania, dhe që përmban biseda në lidhje me gjetjen apo krijimin e punës tuaj ideale. Ky emision bëri që ajo të fillonte të mendonte se si t'i shndërronte njohuritë dhe aftësitë e saj në një biznes të ri.

“Herë pas here protagonistët në program tregonin se sa të vështirë e kishin të gjenin njerëz të kualifikuar për të punuar në nivel ndërkombëtar. Takova disa prej tyre, nga industria e hotelerisë dhe restoranteve dhe të gjithë konfirmonin të njëjtën gjë - nuk gjejmë dot njerëz të kualifikuar - dhe pikërisht këtu hyjmë ne” - thotë Gladiola, duke rikonfirmuar motivimin që gjeti tek programi radiofonik, çka e bëri të shihte mundësitë që ajo e dinte se ekzistonin: **“Edhe përpara se të studioja, e dija që për shkak të kushteve të saj gjeografike Shqipëria do të bëhej një vend i vizituar. E pra, prindërit e mi kishin të drejtë kur thonin se për ata që kanë njohuritë e duhura do të ketë edhe punë. Por kur dëgjoja në radio se sa të vështirë e kishin bizneset që tregjenin njerëz të kualifikuar, e kuptova se e vetmja gjë që më mbante larg suksesit ishte pavendosmëria ime”**.

Ajo vendosi të hapte Akademinë e Turizmit dhe Mikpritjes në tetor të vitit 2015 dhe në më pak se një vit 36 persona u diplomuan në kurset: Bar, Restorant dhe Recepton. Tani Akademia po punon për futjen e kurseve për Menaxhim Eventesh dhe Operator Turistik. Akademia e Turizmit dhe Mikpritjes mbahet vetë ekonomikisht, dhe ky fakt është shumë inkurajues për Gladiolën. **“Ne kemi kërkesë të madhe nga bizneset për të diplomuarit nga kurset tona; edhe pse nuk kemi**

or creating, your ideal job. The show made Gladiola think of how to make her skillset the centerpiece of a new business.

“Time and again in the show were people who stated that it was very hard for them to get people who are ready to work at international standards. I met several people from the hotel and restaurant industry and all of them stated basically the same thing: we can't get trained people. And that is where we come in.” – says Gladiola, reinforcing the motivation she got from the radio show, which made her see the opportunities she suspected were there. **“Even before I went to hospitality school I knew that with its geographical conditions Albania is bound to become a visited country. So my parents were right! There will be jobs for those with good skills. But when I kept hearing businesses on the radio go on about how hard was to find certified people, I saw that the only thing keeping me from success was my indecision.”**

She decided to open the Hospitality and Tourism academy in October 2015 and in less than She She decided to open the Hospitality and Tourism academy in October 2015 and in a few months 36 people had already graduated from the Bar, Restaurant and Reception courses. The Academy is now also working to introduce courses in Event Management and Tour Operator. The Hospitality and Tourism Academy is capable of sustaining itself economically, and this is very encouraging to Gladiola. **“We have a tremendous request by businesses for people who**

mjaftueshëm studentë, ky fakt do të ndryshojë. Ne pranojmë tashmë “Kartën Studentore”, që do të thotë se studentët e rinj përfitojnë një zbritje prej 20 % në koston e çdo kursi që ata marrin”.

Ndërkohë Akademia ofron mbështetje ekstra, pa pagesë, për punësim dhe zhvillim të mëtejshëm profesional. Me 3 seminare të ofruara çdo 3 muaj për ish-studentët e saj, akademia i mban ata të përditësuar, duke i ndihmuar që të ndjekin mundësi më të mira punësimi. Për vitin e ardhshëm synimi është të trajnohen të paktën 240 të rinj, dhe për perspektivën afat-gjatë Gladiola parashikon programe më të gjata trajnimi të cilat do të konsistojnë në një numër më të madh modulesh të kombinuara për dije më të thella e për më shumë profesionalizëm. Deri më tani, 90% e të diplomuarve që ishin në fillim të papunë ose në kërkim për të ndryshuar punë, janë punësuar ose ngritur në detyrë, dhe në të gjitha rastet akademia ndërmjetësoi për të paktën një intervistë pune. Shumica e të diplomuarve janë të punësuar në hotele, bare e restorante shumë të mira, ku kërkohet një nivel specifik profesionalizmi dhe për këtë arsye edhe pagat janë të mira.

have graduated our courses, we just don't have enough students yet, and that's bound to change. We are now accepting 'The Youth Card' which means that the younger students get a 20% discount on the cost of each course they take.”

Meanwhile the academy provides extra support, free of charge, to find a job and further professional development. With 3 free seminars offered every 3 months to its alumni, the academy keeps them up to date, helping them chase better employment opportunities. The projection for the next year is to train at least 240 young people, and for the long run Gladiola foresees longer training programs which will consist in a bigger number of modules for a more in-depth learning and higher professionalism. Right now, 90% of graduates that were at first unemployed or wanted to change their job got hired or promoted, and all of them got at least one job interview mediated by the academy. Most of the graduates are employed in luxury hotels, gourmet restaurants and lounge bars where a specific level of professionalism is required and with good salaries.

